



Datë: 04.08.2025

Numër Protokolli: 5336/2025

A.nr.955/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.955/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi D.Z, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi me Nr.382/V/2025 të datës 22.05.2025, e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa lënda e ankuesit D.Z në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Shëndetësisë të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ashtu që të rishqyrtoj dhe vendos për kërkesën e palës ankuese të datës 19.05.2025 dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marr për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, D.Z (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 23.05.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3421/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.382.V/2025 të datës 21.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensimin e funksionit shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 09.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari I Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 4529/2025, të datës 07.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.955/2025 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3421/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Akt emërimit me numër protokolli 2283 të datës 21.12.2011; Përshkrimin e detyrave të punë të datës 21.12.2011; Vendimin me Nr.10/249 të datës 26.02.2025; Vendimin Nr.382.V/2025 të datës 21.05.2025; Provën shtesë të datës 29.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 09.06.2025; Kërkesën me e-mailin e datës 19.05.2025; Përshkrimin e detyrave të punës me numër protokolli 1180 të datës 01.04.2016, për pozitën Drejtor i Departamentit për Licencim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ka bazë të mjaftueshme ligjore që lënda e ankuesit duhet të kthehet në ***ri-shqyrtim*** dhe ***rivendosje***, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 2283 të datës 21.12.2011, është i punësuar pozitën e punës *Shef i Divizionit për narkotikë/psikotropë/prekursorë* në Agjensionin e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr.02/L-128 për Barna Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursorë, në mbledhjen e datës 26.02.2025, ka nxjerrë Vendimin me Nr.10/249, përmes të cilit akt ka themeluar Komisionit për Narkotikë, ku si rrjedhojë ankuesin e ka caktuar Kryesues të këtij Komisioni, ndërsa sipas pikës III të dispozitivit të këtij vendimi është përcaktuar se financimi dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit do të bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi.

Si rrjedhojë, ankuesi përmes e-mailit të datës 19.05.2025, i është drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, për njohjen e kompensimit për funksionin shtesë sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksionit Shtesë, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë përmes Vendimit me Nr.382/V/2025 të datës 22.05.2025, ka refuzuar kërkesën e ankuesit për funksion shtesë, me arsyetimin se Ministria e Shëndetësisë lidhur me pagesat e trupave profesionale (borde dhe komisione), bazohet në Procedurën Standarde Operative (PSO) me nr.prot.05-7542 të datës 23.11.2023, e cila ndër të tjera parasheh: ***“Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë të cilët shërbejnë në borde, komisione dhe trupa tjerë profesionale nuk marrin kompensim për angazhim e tyre në këto trupa”***.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.382/V/2025 të datës 22.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, pretendon se plotëson në mënyrë kumulative të gjitha kriteret e parapara sipas paragrafit 2 të nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksionit Shtesë, duke theksuar se arsyetimi i vendimit kontestues nuk përkon me dispozitat e kësaj rregulloreje, andaj edhe refuzimi i kërkesës së tij është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i Vendimit me Nr.382/V/2025 të datës 22.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, konstaton se arsyetimi i tij është i mangët dhe nuk gjenë mbështetje ligjore mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksionit Shtesë, rrjedhimisht i njëjti bazohet në një akt të brendshëm që nuk përkon me gjendjen faktike si dhe nuk ndërlidhet me funksionin e ankuesit si Kryesues i Komisionit për Narkotikë, i caktuar me Vendimin Nr.10/249 të datës 26.02.2025, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nga rezulton se akti administrativ i kontestuar me ankesë, për nga përmbajtja dhe arsyetimi nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 48 paragrafit 1 nën paragrafit 2, 3 dhe 4 të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti nuk ka shpjeguar qartë situatën faktike, nuk ka përcaktuar bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret si dhe po ashtu i njëjti akt është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: *“2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërrthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”* dhe si i tillë konsiderohet i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë i njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, me rastin e trajtimit të kërkesës së ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë vendosi që lëndën e ankuesit ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, ndërsa ky i fundit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit duhet të marrë për bazë pikëpamjet juridike të vendimit të Këshillit, në at mënyrë që lidhur me kërkesën e palës të vendos sipas dispozitave të aplikuara ligjore të ligjit për pagat dhe dispozitave të Rregullores QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksionit Shtesë, gjegjësisht të konstatoj se ankuesi në cilësinë e Kryesuesit të Komisionit për Narkotik, të caktuar përmes Vendimit Nr.10/249 të datës 26.02.2025, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës a i plotëson në mënyrë kumulative të gjitha kriteret për përfitimin e kompensimit për funksionin shtesë në kuptim të paragrafit 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, dhe mbi këtë bazë përmes aktit administrativ Sekretari i Përgjithshëm duhet të vendos për çështjen e hapur administrative sipas kërkesës së palës të datës 19.05.2025, ndërsa palën duhet ta njoftojë me aktin e nxjerrë siç parashihet me dispozitat e LPPA-së.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.955/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit D.Z;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.